

VENDIM
Nr. 71, datë 11.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 11.6.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 22 (E) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Enkeleda Kapedani, përfaqësuar nga avokatja Joana Qeleshi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Vladimir Mara.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 672, datë 23.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 253 (87-2024-368), datë 13.12.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-376, datë 27.2.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 672, datë 23.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; datë 25.11.2024, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 11/703, datë 16.1.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrit nr. 53 (87-2025-69), datë 6.3.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1160, datë 10.7.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Urdhërimi i heqjes së sekuestros mbi sendet “Telefon celular, marka iPhone, model 13 ProMax; telefon celular iPhone 6; telefon celular iPhone 13; tablet i markës Acer; laptop i markës Acer; laptop i markës Lenovo dhe kthimin e tyre kërkuases.

Ose në alternativë

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1160, datë 10.7.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 15, 17, 35, 36, 37, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim kërkesën e kërkuases Enkeleda Kapedani (*kërkuesja*), për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe konstatoi mungesën e mendimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan deri në datën 18.5.2022. Në datën 7.9.2023 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 193/2023 dhe kërkuesja nuk rezulton të ketë asnjë pozitë procedurale në këtë procedim penal. Në kuadër të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 672, datë 23.11.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, duke lejuar edhe kontrollin e banesës së kërkuases. Në datën 25.11.2024 oficerët e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë kryer kontrollin e banesës së kërkuases dhe kanë sekuestruar disa sende (3 aparate celularë, 1 tablet, 2 laptopë dhe 1 kopje dokumenti - vendim gjyqësor). Me vendimin e datës 25.11.2024, Prokuroria e Posaçme ka vleftësuar të ligjshëm sekuestron e këtyre sendeve.

2. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me ankim për ndryshimin e pjesshëm të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për pjesën që ka vendosur kontrollin e banesës së saj. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 253, datë 13.12.2024, ka vendosur mospranimin për shqyrtim të ankimit, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-376, datë 27.2.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuases.

3. Në datën 6.8.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë lejuar kontrollin e banesës së saj, e cila është regjistruar me nr. 22 (E) 2025 të Regjistrat Themeltar. Në datën 7.11.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

4. Në vijim, me kërkesën e datës 6.12.2024, kërkuesja ka vënë në lëvizje edhe një proces tjetër gjyqësor, me objekt heqjen e sekuestron mbi sendet e sekuestruara gjatë kontrollit të banesës të datës 25.11.2024 dhe kthimin e tyre. Në lidhje me këtë kërkesë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 11/703, datë 16.1.2025, ka vendosur rrëzimin e saj. Ky vendim është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 53 (87-2025-69), datë 6.3.2025, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1160, datë 10.7.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja.

5. Kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar kërkesën e saj për heqjen e sekuestron dhe kthimin e sendeve të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës, e cila është regjistruar në datën 17.11.2025 me nr. 36 (E) 2025 të Regjistrat Themeltar. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 16.1.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

6. Në datën 26.1.2026, Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të nenit 19 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, vendosi bashkimin e dy kërkesave të paraqitura nga kërkuesja, pasi konstatoi se kishin lidhje me njëra-tjetrën, me qëllim shqyrtimin e përbashkët të tyre. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve mori numrin e çështjes së regjistruar më parë në Gjykatë, konkretisht 22 (E) 2025 të Regjistrat Themeltar, datë 6.8.2025.

7. Në datën 10.6.2026 kërkesja ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga kërkesa dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar se i është cenuar e drejta për jetë private, e garantuar nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së, e lidhur me të drejtën e pronës private, si vijon:

8.1. Në aspektin substancial, për shkak të shtrirjes së pakufizuar të vendimit për lejimin e kontrollit dhe mungesës së arsytimit për dyshimin e arsyeshëm për rastin e kërkeses. Sendet e sekuestruara gjatë kontrollit, ndonëse përmbajnë të dhëna kompjuterike, nuk kanë qenë të specifikuara në vendimin për lejimin e kontrollit, në kundërshtim me vendimit njësuës nr. 147/2021, ndërsa oficerët e Policisë Gjyqësore kanë tejkaluar kompetencat duke sekuestruar sende të papërcaktuara në atë vendim.

8.2. Në aspektin procedural është cenuar:

8.2.1. E drejta e aksesit e lidhur me ankimin efektiv, për shkak të vlerësimit të gjykatave se ndaj vendimit për lejimin e kontrollit nuk lejohet ankim. Nëse ligjvënësi do të kishte qëllim ndalimin e kësaj të drejte, duhet ta kishte parashikuar shprehimisht atë.

8.2.2. Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, përfshirë mosrespektimin e modaliteteve të sekuestrimit të të dhënave dhe pajisjeve kompjuterike.

9. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkeses nuk janë me natyrë kushtetuese, por atribut i gjykatave të zakonshme.

9.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për jetë private në aspektin substancial nuk qëndron, pasi sekuestrimi është kryer në përputhje me ligjin dhe për qëllime të ligjshme. Masa ka konsistuar në sekuestrimin e pajisjes elektronike si burim prove, dhe jo për përdorimin e përmbajtjes të të dhënave jashtë objektit të hetimit. Ky veprim ka karakter urgjent dhe është i kontrollueshëm “ex post” nga gjykata, në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe garancive të vendosura nga Gjykata me vendimin nr. 44/2025, i cili, megjithatë, nuk ndalon sekuestrimin e pajisjeve elektronike dhe as nuk ka fuqi prapavepruese.

9.2. Edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për jetë private në aspektin procedural nuk qëndron, pasi çdo pretendim kryesor i kërkeses është trajtuar nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë. Ato e kanë vlerësuar sekuestrimin të ligjshëm, proporcional dhe të nevojshëm për hetimin e veprave të ndjekura, duke ruajtur balancën ndërmjet nevojës për mbledhjen e provave dhe të drejtave të kërkeses.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Gjykata vëren se në datën 10.6.2026, një ditë përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, kërkesja, që ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, ka paraqitur kërkesë me objekt: “Heqje dorë nga kërkesa dhe pushimin e gjykimit të çështjes”, në të cilën ka parashtuar se heq dorë vullnetarisht nga kërkesa e paraqitur prej saj dhe se në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethana që imponojnë vijimin e shqyrtimit të saj për shkak të interesit publik. Kërkesa i është komunikuar subjektit të interesuar brenda ditës në të cilën është depozituar në Gjykatë dhe subjekti i interesuar nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me të.

11. Neni 31/b i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon të drejtën e kërkesit për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e

gjykimit të çështjes, përveçse kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë të drejtë kërkuarit në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

12. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimit për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkuarës në këtë rast janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetues dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit. Për pasojë, gjykimi i çështjes duhet të pushohet, bazuar në nenin 31/b të Ligjit Organik të Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.6.2026.

Shpallur më 29.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska,
Sonila Bejtja, Asim Vokshi